



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 215/1 Prot.

Elbasan më 02. 2. 2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.12 datë 30.01.2024 “Për miratimin e bashkëfinancimit në masën 30% të projektit social “Për përmirësimin e kushteve të banesave për komunitetet e pafavorizuara dhe shtresat në nevojë”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Majlinda Perriu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.01.02.2024

Nr. 642/prot
11

Nr.12 dt.30.01.2024

“PËR MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT NË MASËN 30% TË PROJEKTIT SOCIAL “PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË BANESAVE PËR KOMUNITETET E PAFAVORIZUARA DHE SHTRESAT NË NEVOJE”

Duke u mbështetur në Ligjin Nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore. Këshilli Bashkiak I mbledhur sot më datë 30.01.2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

VENDOSI:

1. Te miratojë në parim bashkëfinancimin deri në masën 30% të projektit me vlerë 15,690,829.7 lekë.
"Përmirësimin të kushteve të banesave për komunitetet e pafavorizuara dhe shtresat në nevojë" i cili do të aplikohet nga Bashkia Librazhd në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
2. Efeket financiare të pikës 1 të këtij vendimi do të perballohen nga buxheti i Bashkisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorial (Zyra e Shërbimeve dhe Strehimit) si dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.
4. Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjete) ditë pas shpalljes

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU